



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRAN

Nr. / Br. 51346/21

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data / Datum: 21/09/21

VUSHTRRI - VUÇITRAN

REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



## PROCESVERBAL

**Nga takimi me qytetarë mbajtur në fshatin Stanoc i Ulët, lidhur me dëgjimet buxhetore për vitin 2022-2024**

Mbledhja u mbajt me datën 29.08.2021 me fillim në ora 19:00, në shtëpinë e komunitetit. Prezent nga zyrtarët e komunës:

1. z. Xhafer Tahiri- kryetar i komunës
2. z. Afrim Namani –nënkryetar i komunës, etj.

Nga banorët e atij lokaliteti ishin të pranishëm 37 pjesëmarrës. Prej tyre 31 meshkuj dhe 6 femra.

### Rend Dite

1. Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2022-2024

### Fjala hyrëse:

Kryetari i komunës zotëri Xhafer Tahiri fillimisht i njoftoj të pranishmit në pika të shkurtra lidhur me investimet e bëra gjatë këtyre viteve të udhëheqjes së tij me komunën, duke filluar me projektet infrastrukturore si shtrimin e rrugëve me asfalt, subvencionet e dhëna për fermerët, investimet në objektet edukativo-arsimore, ndërtimi i fushave sportive, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtatit të lumenjve, rregullimin e shesheve në qytet, prurjen e ujit të pijes në pothuajse tërë territorin e komunës, menaxhimin e mbledhjes së mbeturinave, projekti pothuajse në mbarim për ndërtimin e zonës ekonomike, etj.

Kryetari i këshillit të fshatit Stanoc i ulët zotëri Rrahim Ajeti falënderoj kryetarin e komunës zotëri Xhafer Tahirin për përkrahjen e projekteve të ndryshme në këtë lokalitet.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, u hap diskutimi:

1. Mehdi Bregaj, kërkon të ketë ndriçim në rrugën ku banon , dhe rregullimin e kanalizimit.
2. Ilaz Gashi , kërkon të bëhet rrethimi i oborrit të shkollës në Lum të Madh, rruga “Nexhat Hetemi” të rregullohet dhe të bëhet me trotuar.
3. Avdullah Sadiku, kërkon që përroi të funksionalizohet pasi që pothuajse është mbyllë.
4. Ismajl Cakaj, kërkon të rregullohet kanalizimi në lagjen “Zena” afër “Binnit”, gjithashtu thotë se afër autosallonit “Shala” ka probleme me ujërat atmosferike.
5. Rrahim Ajeti, kërkon një çerdhe për 4 fshatrat për rreth. Trotuar 1.5 km në rrugën kryesore të fshatit, gjithashtu vendosjen e ventillave në çdo lagje, në mënyrë që të bëhet ndërprerja në ventilla.  
Ndërtimin e një salle të sportit, ndërtimin e një muzeu.

Në fund të këtij takimi u theksua se këto kërkesa do të shqyrtohen në ekzekutivin e komunës, Komitetin për politikë dhe financa dhe rekomandohen për miratim në kuvendin e komunës për aprovim varësisht prej prioriteteve që do të përcaktohen si dhe varësisht prej disponueshmërisë buxhetore për investime kapitale për v. 2022-2024.

Procesmbajtës:

Premtim Maloku

